



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1503 Prot

Datë 17 . 11 .2022

Nr. 940 Prot

Datë 17 . 11 .2022

**KOMISIONIERI PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
DHE
KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Tiranë, nëntor 2022

PREAMBUL

Shkolla e Magjistraturës dhe Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të quajtura *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mekanizmave ligjorë zbatues të tij;

Duke u angazhuar për marrjen përsipër sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke konfirmuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave institucionale dhe gjyqësore;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit është efikasiteti dhe eficaenca në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira vendase dhe ato evropiane;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij memorandumi për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të integritimit Evropian të vendit;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale: në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996 "*Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; ligjin Nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", ligjin Nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", dhe në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2014 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" i ndryshuar.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur

Memorandumi.

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkërendimi i ndërsjellët e reciprok i veprimtarisë institucionale midis palëve nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit, nxitja e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive të formimit profesional të punonjësve të stafit të KMD për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë profesionale si dhe ndërgjegjësimi i aktorëve të tjerë në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe më veçanërisht në fushën e të drejtës për mos diskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit, si dhe promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, në ofrimin e shërbimeve publike.

2. Nëpërmjet këtij memorandumi synohet

- a) gatishmëria e të dy institucioneve për të koordinuar aktivitetet e trajnimit, dhe domosdoshmërinë për të institucionalizuar këtë bashkëpunim.
- b) shkëmbimi i programeve përkatëse vjetore të trajnimit si një instrument që do të përmirësojë dhe koordinojë më tej përpjekjet institucionale në këtë drejtim.
- c) shkëmbime lektorësh të cilat do t'i shërbejnë shkëmbimit të ekspertizës dhe eksperiencës së përbashkët.
- d) pjesëmarrje në konferenca, trajnime vijuese dhe lokale të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.
- e) orë leksionesh të organizuara nga Komisioneri me Magjistratët e rinj në kuadër të promovimit të ligjit dhe praktikave më të mira gjyqësore kombëtare dhe vendime të Strasburgut.
- f) forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit të KMD;

Neni 2 **Objekti i bashkëpunimit**

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për hartimin dhe implementimin e programeve të posaçme për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional sipas roleve dhe përgjegjësisve të parashikuara në këtë memorandum.

Palët angazhohen të bashkëpunojnë me qëllim trajtimin e rasteve/çështjeve me objekt të drejtën e mos diskriminimit, në referencë të ligjit nr.10221/2010 si dhe në dritën e *Jusprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut*

Neni 3

Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

- I. Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi realizohet si vijon:
 - a) KMD propozon listën e aktiviteteve që do të përfshihen në veprimtarinë e formimit profesional:
 - I. harton listën e punonjësve të stafit që do të marrin pjesë në aktivitetet e formimit profesional;
 - II. cakton një person kontakti në cilësinë e koordinatorit, i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e zhvillimit të aktiviteteve të formimit profesional;
 - III. përcakton formatin e regjistrimit të të dhënave lidhur me frekuentimin dhe tematikën e aktiviteteve të formimit profesional; Shkolla e Magjistraturës përcakton listën e aktiviteteve që do të përfshihen në programin e formimit profesional të punonjësve të KMD;
 - IV. siguron teknikat dhe metodologjinë e zhvillimit të programit të formimit profesional;
 - V. harton listën dhe mundëson pjesëmarrjen e ekspertëve për çdo aktivitet të formimit profesional dhe bashkëpunon me ta lidhur me metodologjinë e ekspertizës që do të ofrohet;
 - VI. organizon sesionet trajnuese për trajnerët;
 - VII. përcakton kalendarin e aktiviteteve të formimit profesional.
2. Palët marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:
 - a) sigurimin e mjeteve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional;
 - b) hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të aktiviteteve trajnuese.

Neni.4

Forma e bashkëpunimit

1. Për efekt të efikasitetit në kohë dhe kosto, njoftimi i pjesëmarrësve dhe çdo komunikim tjetër, do të kryhet nëpërmjet postës elektronike dhe kur është e mundur në adresat zyrtare.
2. Shkolla e Magjistraturës njofton nëpërmjet Sekretarisë Shkencore së Programit të Formimit Vazhdues Koordinatorin e KMD-së lidhur me aktivitetet e formimit profesional dhe modalitetet e zhvillimit të tyre, jo më vonë se 15 dite nga data e aktivitetit.
3. Koordinatorin e KMD mban kontakte me Sekretarinë Shkencore të Programit të Formimit vazhdues lidhur me:
 - a) listat e pjesëmarrësve në aktivitetet e formimit profesional;
 - b) çdo informacion që lidhet me zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional.

Neni 5
Llojet e aktiviteteve të formimit profesional

Llojet e aktiviteteve të formimit profesional në të cilat do të bashkëpunohet janë:

1. Seminare;
2. Tryeza të rrumbullakëta;
3. Grupe të përbashkëta pune për studimin e projekteve.

Neni 6
Komunikimi mes palëve

Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë,

Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 7
Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 8
Ndryshimi i Memorandumit

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 9
Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky memorandum zbatohet për periudhën -----

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve



Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 11
Hyrja ne Fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Shkollën e Magjistraturës dhe dy në KMD.

Nënshkruar në Tiranë, më 17 nëntor 2022.

KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI


Robert GAJDA


SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
DREJTOR


Arben RAKIPI